



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.487/18 prot.

Datë 28.04.2026

V E N D I M

Nr. 563 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.320/2026, datë 02.03.2026, për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK, Nipt. K71903025A, Adresa: Rr. Shyqyri Bërxolli, P. Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me Vendim Nr.423/2026, datë 25.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
- 2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën në SPE me të gjitha modifikimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar konstatuar më sipër.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 6743/1 prot., datë 31.03.2026, protokolluar me tonën nr. 487/14 prot., datë 02.04.2026, me objekt “Zbatim Vendimi” autoriteti kontraktor informon, se ka zbatuar vendimin Nr.320/2026, datë 02.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit sipërcituar.

I.3. Me shkresën ardhur me shërbim postar me objekt: Kërkesë për sqarim dhe zbatim vendimi, protokolluar me tonën me nr. 487/15, date 09.04.2026, nga operatori ekonomik ankimues “Optima Communication” ShPK, drejtuar AK-së dhe për dijëni KPP-së, me objekt: Kundërshtim i veprimeve e AK-së dhe shtojcës së publikuar, mbi moszbatim të vendimit mbi modifikime të DST së.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën ardhur me nr. 6743/1 prot., datë 31.03.2026, protokolluar me tonën nr. 487/14 prot., datë 02.04.2026, me objekt “Zbatim Vendimi” autoriteti kontraktor informon, se ka zbatuar vendimin Nr.320/2026, datë 02.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.2. Referuar shkresave të mësipërme, Komisionit të Prokurimit Publik kreu verifikime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi dhe konstatoi se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcë për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Referuar vendimit të KPP-së si edhe përmbajtjes së shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni mori në shqyrtim dokumentet dhe konstatoi, se autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar ka pasqyruar modifikime në kritere e konkretisht ka modifikuar kriterin objekt shqyrtimi me nr. 2.3.2 duke reduktuar numrin e artikujve për të cilët kërkohet Autorizim nga Prodhuesi/Distributori i autorizuar për tregtimin e artikujve TIK, dhe KPP është shprehur mbi modifikim të kriterit 2.3.2 për pajisjet e kërkuara në numër të madh apo me rëndësi të veçantë.

II.3. Sa më sipër, nga analizimi i artikujve të kërkuar në kriterin 2.3.2 të modifikuar me shtojcë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër ka zbatuar plotësisht dhe me korrektësi vendimin e KPP-së, duke kërkuar dokumente për artikujt **me numër të madh apo edhe me rëndësi të veçantë** për Autoritetin Kontraktor, në zbatim të vendimit të Komisionit.

Përsa konstatuar Komisioni gjykon se Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër ka zbatuar Vendimin me Nr.320/2026, datë 02.03.2026, të KPP-së.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

